


Prot. 2106/186M

Datë, 16/06/2021, Tiranë



KËRKESË

Drejtuar: Ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë
Znj. Belinda BALLUKU

Lënda: Kërkesë për informacion

Baza Ligjore:

- Ligji Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", datë 18.09.2014, Fletore Zyrtare Nr. 160, datë 17.10.2014- Neni 3, E drejta e informimit; Neni 11, Kërkesa për informim.
- Ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil"
- Ligji nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore".
- Ligji nr. 10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës Së Shqipërisë", i ndryshuar.

E nderuar zonja Balluku,

Koalicioni për Reforma Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK Albania) ka si mision mbrojtjen dhe garantimin e lirive e të drejtave të njeriut, si dhe të dimensionit të plotë të sigurisë njerëzore nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës, qeverisjes demokratike, nxitjes së aktivizmit e të angazhimit qytetar si dhe nxitjes për përgjegjshmëri, transparencë e llogaridhënie të plotë të institucioneve publike dhe politike.

KRIIK në bashkëpunim me apo në kuadër të Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë (KVV), si një ndër organizatat themeluese dhe drejtuese të KVV, ka ndjekur në vazhdimësi, veçanërisht pas Reformës Zgjedhore të korrikut 2012, zhvillimin e të gjitha proceseve dhe veprimtarive politike dhe institucionale, të cilat afektojnë drejtëpërsëdrejti apo indirekt integritetin e proceseve zgjedhore.

Gjithashtu, KRIIK ka monitoruar në mënyrë të pjesshme apo të plotë të gjitha proceset zgjedhore të zhvilluara në vend që prej Referendumit për miratimin e Kushtetutës së Republikës me 1998 e deri më sot.

Në vazhdim të këtij angazhimi, KRIIK ka monitoruar përgatitjen e procesit zgjedhor për Zgjedhjet Parlamentare të 25 Prillit 2021, si dhe ditën e votimit dhe procesin e numërimit të votave si një organizatë e akredituar prej Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me vendimin nr. 39 datë 18.12.2020. Aktualisht KRIIK është duke monitoruar procesin e ankesave dhe apelimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Kolegjin Zgjedhor.

Referuar sa më sipër, KRIIK shpreh Konsideratën e tij për bashkëpunimin në vazhdimësi me Ju dhe Institucionin që ju drejtoni dhe, mbështetur në bazën ligjore të sipërpërmendur,

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj. Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Ju paraqet kërkesën për të patur kopje të informacionit të mëposhtëm:

1. Kopje të Urdhrit të Brendshëm të Ministrisë që Ju drejtoni "Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor", sipas përcaktimeve të ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" dhe Udhëzimit të Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil "Mbi monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor".
2. Kopje të Rregullores së brendshme të veprimtarisë së grupit të punës të ngritur sipas pikës 1.
3. A ka patur nëpunës të administratës së institucionit që Ju drejtoni dhe institucioneve në varësi, të cilët kanë qenë kandidatë për deputetë në zgjedhjet e datës 25 prill 2021?
 - 3.1 Nëse po, lutemi na specifikoni emrat e këtyre nëpunësve.
 - 3.2 A kanë kërkuar pezullim nga detyra nëpunësit e përfshirë në pikën 3.1?
 - 3.3 Nëse po, lutemi kopje akteve të pezullimit të secilit prej tyre.
4. A kanë kërkuar nëpunës, civilë ose jo, të institucionit që ju drejtoni të kryejnë funksione në administratën zgjedhore?
 - 4.1 Nëse po, sa nëpunës janë autorizuar?
 - 4.2 Lutemi na vini në dispozicion një kopje të autorizimit, për çdo nëpunës të administratës shtetërore në varësinë tuaj.
5. A ka patur raste të konstatimit të shkeljeve nga Grupi i punës?
 - 5.1 Nëse po, lutemi kopje të procesverbalit të konstatimit të shkeljes përkatëse.
 - 5.2 Si është proceduar në vazhdim nga Grupi i punës lidhur me shkeljen e konstatuar, dhe a ka ndonjë vendim apo proçedim të ndërmarrë lidhur me shkeljen e konstatuar.
6. Sa është numri i nëpunësve civilë në administratën e institucionit që Ju drejtoni dhe në institucionet në varësi, të kategorizuar sipas secilit institucion, dhe sa i atyre që janë në proces marrje të këtij statusi.
7. Sa është numri i nëpunësve publikë, të cilët nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil, në administratën e institucionit që Ju drejtoni dhe në institucionet në varësi, të kategorizuar sipas secilit institucion.

Informacioni i kërkuar mund të vihet në dispozicion edhe nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@kriik.al ose info.kriik@gmail.com.

Duke Ju falënderuar paraprakisht për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj. Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Me Konsideratë,

Premto GOGO

Kryetar